**Hapet thirrja për aplikime për bursa trajnimi në Šiauliai State University of Applied Sciences, Lituani, për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për të marrë pjesë në Javën Ndërkombëtare që ky universitet do të organizojë.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për trajnim për stafin me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për të marrë pjesë në aktivitetin "Staff Week" që ky universitet do të organizojë në datat 11 – 15 Prill 2022, me temë "Erasmus+ – When, if not Now?".

https://svako.lt/en/international-relations/erasmus-plus/guide-for-incoming-staff-mobility

**Llojet e mobilitetit:**

-Shkëmbimin e stafit me kohë të plotë për trajnim;

**Kohëzgjatja:**

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit (datat 11 – 15 Prill 2022);

**Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin ditor për stafin (140 EUR në ditë);
-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| **DISTANCA E UDHËTIMIT** (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | **Kompensimi** |
|---|---|
| **Midis 100 dhe 499 KM** | 180 EUR |
| **Midis 500 dhe 1999 KM** | 275 EUR |
| **Midis 2000 dhe 2999 KM** | 360 EUR |
| **Midis 3000 dhe 3999 KM** | 530 EUR |
| **Midis 4000 dhe 7999 KM** | 820 EUR |
| **8000 KM ose më shumë** | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:
http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

**Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;

-Vetëdeklarim në jeni shpallur fitues ose keni kryer një bursë shkëmbimi Erasmus+ më parë (nëse po, ku)
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën: https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

**Afati për aplikim**: **23 Shkurt 2022**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!